

Vendim nr. 176, datë 29.05.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Ilir Toska, Anëtar

Genti Ibrahim, Anëtar

në datën 29.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (Sh) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SHOQATA E PENSIONISTËVE SHQIPTARË “THINJAT”, përfaqësuar nga presidenti Ilir Goci.

OBJEKTI: Shfuqizimi i shkronjës “a” i paragrafit të parë i nenit 3, paragrafit të parë i nenit 4 dhe paragrafit të parë i nenit 5 të ligjit nr. 7/2025, datë 30.01.2025 “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Pezullimi i zbatimit të ligjit deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 15, 17, 18, pika 1, 41, 42, 131, shkronja “a”, 132 dhe 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1, 6, pika 1, 13, 14, 18 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 1 i Protokollit nr. 1 dhe neni 1 i Protokollit nr. 12 të Konventës; ligji

nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji Organik i Gjykatës).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 30.01.2025 Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 7/2025 “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore” (*Ligji për Njohjen e Punësimit për Pension*). Ligji është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 40, datë 26.02.2025, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit.

2. Ligji për Njohjen e Punësimit për Pension ka për qëllim njohjen si periudhë sigurimi, për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore, të periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj (*neni 1*). Subjektet përfituese të tij janë personat që kanë të drejtën për të kërkuar njohjen si periudhë të përgjithshme sigurimi, sipas këtij ligji, kur u lind e drejta për të kërkuar caktimin e një pensioni nga sigurimet shoqërore (*neni 2*). Kërkesat për pensione në të cilat janë deklaruar periudha punësimi në institucionet shtetërore, ish ndërmarrjet shtetërore, ish-ndërmarrjet bujqësore dhe ish-kooperativat bujqësore, që nuk plotësojnë kushtet për t’u njohur sipas këtij ligji ose në detyra/funksione specifike, llogaritja e të cilave ka efekte më të favorshme në masën e pensionit se periudhat që njihen sipas neneve 3, 4 dhe 5 të këtij ligji, me kërkesën e përfituesit, ndjekin procedurën sipas legjislacionit në fuqi (*neni 6*). Të drejtat e fituara nga ky ligj janë objekt rivlerësimi vetëm për vendimmarrje me efekte më të favorshme në masën e pensionit (*neni 7*). Periudhat e punësimit të njohura me ligje të veçanta, për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore, vazhdojnë të njihen të tilla dhe nuk janë objekt trajtimi sipas këtij ligji (*neni 10*).

3. Periudhat e punësimit të njohura nga ky ligj përcaktohen në nenet 3, 4 dhe 5. Konkretisht, neni 3, i emërtuar “Periudhat e punësimit në institucione shtetërore dhe ish-ndërmarrje shtetërore”, në pikën 1, shkronja “a”, parashikon se: “1. Njihet si periudhë e

përgjithshme sigurimi për efekt pensioni nga sigurimet shoqërore koha e punësimit në institucionet shtetërore dhe në ish-ndërmarrjet shtetërore: a) nga mosha 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Neni 4, i emërtuar “Periudhat e punësimit në ish-kooperativat bujqësore”, në pikën 1 përcakton se: “1. Njihet si periudhë e përgjithshme sigurimi në ish-kooperativë bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore nga mosha 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, por jo më herët se viti i krijimit të kooperativës bujqësore, deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar.”. Ndërsa neni 5, i emërtuar “Periudhat e punësimit në ish-ndërmarrjet bujqësore”, në pikën 1 parashikon se: “1. Njihet si periudhë e përgjithshme sigurimi në ish-ndërmarrjet bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore, nga mosha 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, por jo më herët se data e krijimit të ish-ndërmarrjes bujqësore, deri në hyrjen në fuqi të vendimit nr. 452, datë 17.10.1992 të Këshillit të Ministrave “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore.”.”

4. Në zbatim të këtij ligji, Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) ka nxjerrë Rregulloren e cila përcakton kriteret, dokumentacionin dhe procedurat administrative të vlerësimit të kërkesës “Për caktim pensioni”, në të cilën deklarohet edhe periudha e sigurimit objekt i ligjit.

5. Në datën 04.03.2026 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë, sipas objektit, e cila, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 17.03.2026.

II

Pretendimet e kërkuases

6. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se dispozitat ligjore të kundërshtuara cenojnë:

- 6.1. *Parimet e shtetit të së drejtës dhe të barazisë përpara ligjit*, të garantuara nga nenet 4 dhe 18 të Kushtetutës, pasi, për shkak të moshës, trajtojnë ndryshe individët, duke mos siguruar qasje të njëjtë në përfitimin e të drejtave të pensionit. Ligji trajton ndryshe situata të njëjta, krijon diskriminim dhe pabarazi midis qytetarëve shqiptarë. Për rrjedhojë, janë cenuar edhe dinjiteti njerëzor, si dhe të drejtat ekonomike e sociale.
- 6.2. *Parimin e proporcionalitetit*, pasi përjashtohen nga përfitimi individët e moshave 14-18 vjeç, që kanë kontribuar në sistemin shtetëror dhe bujqësor. Masa duhet të ishte

më pak kufizuese, duke njohur si periudhë punësimi nga mosha 15 vjeç në përputhje me legjislacionin historik. Përjashtimi absolut nuk është proporcional.

- 6.3. *Parimin e hierarkisë së normave dhe të konfliktit të interesave*, pasi ligji duhet të jetë i përgjithshëm dhe në funksion të interesit të shoqërisë dhe jo të disa individëve. Nuk mund të konsiderohet ligj një normë, e cila nuk synon rregullimin e situatave të përgjithshme dhe nuk mbart karakter universal, të mbështetur në interesin e përgjithshëm publik. Në realitet është shtrembërim i kushteve dhe i kriterëve të ligjit në funksion ose në shërbim të interesit të një individi.
- 6.4. *Parimin e sigurisë juridike*, pasi ligji nuk harmonizohet me kuadrin ligjor në fuqi, veçanërisht me ligjin nr. 169/2020 “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore” (*Ligji për Njohjen e Punësimit në ish-Kooperativat Bujqësore*). Ky i fundit, me të drejtë, njeh moshën reale të punës në ish-kooperativat bujqësore sipas legjislacionit të kohës, që lejonte individin nga mosha 14 vjeç të punonte e të kishte të ardhura nga paga. Ndërsa Ligji për Njohjen e Punësimit për Pension përjashton periudha reale pune dhe redukton bazën e llogaritjes së pensionit, duke cenuar konkretisht dhe realisht pritshmëritë legjitime të një kategorie qytetarësh.
- 6.5. *Të drejtën e pronës*, pasi e drejta e pensionit përbën pasuri kur ekziston bazë ligjore dhe krijohet një pritshmëri e ligjshme. Në rastin konkret, puna është kryer në mënyrë të ligjshme, pasi shteti e ka organizuar dhe administruar, ndaj individët kanë krijuar pritshmëri se ajo do të merret parasysh në sistemin e sigurimeve. Ligji ka përjashtuar arbitrarisht një segment të periudhës historike të punës, duke ndërhyrë në interesin pasuror të individëve. Reduktimi i të ardhurave ndikon në nivelin e jetesës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “a”, dhe 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, si dhe nenit 49, pika 3, shkronja “d”, të Ligjit Organik të Gjykatës, të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare e kanë edhe organizatat, të cilat janë subjekt i kushtëzuar, në kuptimin që duhet të justifikojnë interesin e tyre për çështjen e parashtruar. Përveç interesit, kërkesa duhet të plotësojë

edhe kriteret e tjera paraprake, të parashikuara nga nenet 49 dhe 50 të Ligjit Organik të Gjykatës, të cilat lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës dhe natyrën kushtetuese të pretendimeve.

8. Kriteret paraprake të pranueshmërisë janë me natyrë kumulative, që do të thotë se mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që gjykimi kushtetues të mos vihet në lëvizje. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve paraprake, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë, si pasojë, moskalimin e saj në seancë plenare.

9. Në çështjen konkrete, Kolegji vlerëson të analizojë nëse pretendimet kanë natyrë kushtetuese, që lidhen me legjitimitimin *ratione materiae* të kërkueses. Në këtë drejtim, kërkuësja ka pretenduar se dispozitat e kundërshtuara kanë cenuar parimet e shtetit të së drejtës dhe të barazisë përpara ligjit, parimin e proporcionalitetit, parimin e hierarkisë së normave dhe të konfliktit të interesave, parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën e pronës, të garantuara nga nenet 4, 17, 18 dhe 41 të Kushtetutës. Argumenti kryesor i parashtruar nga kërkuësja ka të bëjë me periudhën e punësimit, për të cilin ligji i kundërshtuar parashikon si prag minimal moshën 18 vjeç, ndaj, sipas saj, ligji nuk merr në konsideratë individët të cilët kanë punuar duke filluar nga moshja 14 vjeç, sipas legjislacionit të kohës.

10. Duke iu referuar thelbit të argumentit, Kolegji vëren se pretendimet e kërkueses lidhen me të drejtën për pension, të garantuar nga neni 52 i Kushtetutës. Kjo dispozitë kushtetuese parashikon se kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj.

11. Jurisprudenca kushtetuese ka pohuar se e drejta e pensionit përfshihet në grupin e të drejtave ekonomike, sociale, të cilat për nga natyra e tyre janë të drejta pozitive. Prandaj, përmbajtja e tyre duhet interpretuar në lidhje të ngushtë me detyrimin e shtetit për t'u bërë aktiv e për t'u garantuar shtetasve sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore në rastet e fatkeqësive, të sëmundjeve, invaliditetit, pleqërisë dhe papunësisë së padëshiruar (*shih vendimet nr. 33, datë 24.06.2010; nr. 9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata ka evidentuar se neni 52 i Kushtetutës ka parashikuar të drejtën themelore për sigurime shoqërore në pleqëri të kujtdo, duke marrë në mbrojtje individin për t'i siguruar atij mjete jetese në formën e mbështetjes ekonomike nga shteti, kur ai është në moshën e pleqërisë ose kur është i paaftë për punë. Këto situata vulnerabiliteti të individit, në thelb, nuk varen prej vullnetit të tij. Kjo do të thotë se shteti, në mënyrë të detyrueshme, nëpërmjet politikave të tij sociale,

aktivizohet për të marrë masa që t'i garantojë individit mbrojtje pozitive, në formën e përfitimeve financiare, ku bën pjesë edhe pensioni i pleqërisë. Masat e ndërmarra nga shteti, si pjesë e politikave sociale të tij, duhet të ofrohen në mënyrë vazhduese, me qëllim gëzimin e pandërprerë të tyre nga individët dhe ruajtjen e një standardi të caktuar të mjeteve të jetesës (*shih vendimin nr. 10, datë 07.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit, Gjykata ka theksuar se barazia në ligj dhe përpara ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë mund të përliqjet vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet (*shih vendimet nr. 34, datë 10.04.2017; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 4, datë 12.02.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Mbi bazën e këtyre standardeve, Kolegji konstaton fillimisht se e drejta e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose e drejta për pension, sipas nenit 52 të Kushtetutës, në përputhje me delegimin kushtetues, rregullohet nga ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji për Sigurimet Shoqërore*).

15. Nga ana tjetër, Ligji për Njohjen e Punësimit për Pension nuk rregullon drejtpërdrejt të drejtën për pension dhe as nuk parashikon heqjen ose kufizimin e kësaj të drejte për individët që kanë punuar në moshat 14-18 vjeç, siç pretendon kërkuësja. Në thelb, ky ligj krijon një mekanizëm lehtësues për njohjen e disa periudhave historike të punësimit si periudha sigurimi për efekt pensioni, duke shmangur, në rastet e parashikuara prej tij, barrën e individit për të provuar vjetërsinë në punë/periudhën e sigurimit sipas procedurës së zakonshme. Ky mekanizëm lehtësues është kushtëzuar, së pari, me vullnetin e individit, i cili duhet të paraqesë deklaratën përkatëse dhe, së dyti, me vërtetimin e disa rrethanave faktike, që lidhen me vendbanimin në periudhën përkatëse, dhe me faktin që individi të mos ketë qenë duke vuajtur dënim me heqje lirie gjatë asaj periudhe. Po kështu, ligji ka përcaktuar periudhën maksimale që mund të njihet sipas këtij regjimi të posaçëm, duke vendosur si kufi minimal moshën 18 vjeç dhe, në rastin e punësimit në institucionet shtetërore ose në ish-ndërmarrjet shtetërore kur individi ka përfunduar arsimin e lartë, datën e përfundimit të shkollës së lartë. Në këtë kuptim, pragu i moshës 18 vjeç nuk përbën kufizim të drejtpërdrejtë të së drejtës për pension, por përcakton fushën e zbatimit të një skeme të posaçme lehtësuese për njohjen e periudhave të punësimit pa ndjekur procedurën e zakonshme të të provuarit. Për më tepër, nga përmbajtja e ligjit të kundërshtuar rezulton se kërkesat për pension që

nuk plotësojnë kushtet për t'u njohur sipas këtij ligji ndjekin procedurën sipas legjislacionit të përgjithshëm në fuqi, konkretisht sipas Ligjit për Sigurimet Shoqërore. Për rrjedhojë, individët që pretendojnë njohjen e periudhave të punësimit jashtë kushteve të ligjit të kundërshtuar nuk përjashtohen nga mundësia për të kërkuar njohjen e tyre sipas rrugës së zakonshme ligjore.

16. Kolegji vëren se kërkuësja, në thelb, synon zgjerimin e skemës së posaçme sipas ligjit të kundërshtuar edhe për periudhat e punësimit nga mosha 14 deri në 18 vjeç. Në mënyrën sesi është parashtruar, ky pretendim lidhet me përcaktimin e fushës së zbatimit të një mekanizmi të posaçëm lehtësues në kuadër të sistemit të sigurimeve shoqërore. Në këtë fushë, ligjvënësi gëzon një hapësirë të gjerë vlerësimi, për sa kohë masa e zgjedhur nuk cenon në mënyrë arbitrare ose joproporcionale një të drejtë kushtetuese. Në këtë pikëpamje, mund të thuhet se ligji i kundërshtuar përbën një hap përpara për t'u garantuar individëve një standard të caktuar të mjeteve të jetesës. Duke qenë politikë sociale shtetërore, duhet theksuar se sipas nenit 59 të Kushtetutës, modifikimi i saj, pra zgjerimi për të përfshirë edhe individët e moshave 14-18 vjeç, nuk mund të detyrohet përmes kontrollit kushtetues. Kjo pasi objektivat socialë përmbushen brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon shteti, pra kushtet dhe masa e përmbushjes së tyre përcaktohen nga ligji.

17. Për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, Kolegji vëren se kërkuësja nuk ka arritur të identifikojë një kategori personash që, ndonëse ndodhen në situatë të njëjtë ose të krahasueshme në kuptimin kushtetues, trajtohen në mënyrë të ndryshme nga ligji i kundërshtuar. Përkundrazi, nga përmbajtja e ligjit rezulton se çdo individ që kërkon të përfitojë nga skema e posaçme i nënshtrohet të njëjtit regjim juridik, sipas të cilit periudha e punësimit njihet nga mosha 18 vjeç. Në këtë kuptim, pragu i moshës 18 vjeç nuk krijon trajtim të diferencuar ndërmjet subjekteve që kërkojnë të përfitojnë nga skema, por përcakton kufirin objektiv të fushës së zbatimit të saj. Për më tepër, sikurse u përmend, ky kufi nuk përjashton individët që pretendojnë se kanë punuar përpara moshës 18 vjeç nga mundësia për të kërkuar njohjen e këtyre periudhave sipas procedurës së zakonshme ligjore. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuësës nuk lidhet me trajtimin e pabarabartë të subjekteve në situata të njëjta, por me kërkesën për zgjerimin e fushës së zbatimit të një skeme të posaçme lehtësuese, çka i përket hapësirës së vlerësimit të ligjvënësit në përcaktimin e politikave sociale.

18. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se kërkuësja nuk ka arritur të argumentojë se dispozitat e kundërshtuara heqin të drejtën për pension, përjashtojnë ndjekjen e procedurës së zakonshme për njohjen e periudhave të tjera të punësimit ose krijojnë një trajtim të diferencuar kushtetutshmërisht të papërligjur. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuësës se ligji i kundërshtuar cenon

të drejtën për pension, parimin e barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, janë haptazi të pabazuara.

19. Lidhur me pretendimin e kërkueses se Ligji për Njohjen e Punësimit për Pension nuk është në harmoni me kuadrin ligjor në fuqi, veçanërisht me Ligjin për Njohjen e Punësimit në ish-Kooperativat Bujqësore, Kolegji vëren se ky pretendim mbështetet në mënyrën sesi kërkuesja interpreton këto dy ligje dhe në përfundimin që ajo nxjerr se ato bien në kundërshtim me njëri-tjetrin. Pa paragjykuar saktësinë e këtij interpretimi, Kolegji çmon se, në mënyrën sesi është parashtruar, ky pretendim i kërkueses nuk ngre çështje të natyrës kushtetuese. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të ligjit dhe e harmonizimit ndërmjet dispozitave të tij me ligje të tjera nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues dhe, për rrjedhojë, nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata (*shih vendimet nr. 5, datë 05.02.2015; nr. 1, datë 06.02.2013; nr. 2, datë 03.02.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Pajtueshmëria e normave përkatëse me Kushtetutën mund të vihet në dyshim vetëm kur mungesa e harmonizimit mes ligjeve krijon paqartësi, e cila mund të çojë në zbatim të gabuar të dispozitave ligjore dhe në cenim të parimit të shtetit të së drejtës e të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 43, datë 26.06.2015; nr. 14, datë 22.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kontrolli kushtetues nuk ka për objekt zgjidhjen e çdo mospërputhjeje të pretenduar ndërmjet ligjeve të së njëjtës fuqi juridike, përveçse vërtetohet se kjo mospërputhje prodhon cenim konkret të një norme ose të drejte kushtetuese. Në rastin konkret, Kolegji vlerëson se kërkuesja nuk ka arritur të argumentojë se mospërputhja e pretenduar ndërmjet ligjeve sjell, në vetvete, cenimin e parimeve ose të drejtave kushtetuese të pretenduara prej saj. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

20. Lidhur me kërkimin për pezullimin e zbatimit të dispozitave ligjore të kundërshtuara, sipas nenit 45, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, ai (pezullimi) vendoset nga Mbledhja e Gjyqtarëve ose nga Gjykata në seancë plenare, pra kur vlerësohet se çështja duhet të kalojë për shqyrtim në seancë plenare. Në kushtet kur kërkesa e paraqitur nga kërkuesja nuk plotëson kriteret paraprake, atëherë kërkimi për pezullimin e dispozitave ligjore nuk mund të merret në shqyrtim.

21. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.